


PËRMBAJTJA		2
HYRJE		4
1	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	5
1.1	Historiku i Kompanisë	5
1.2	Deklerata e politikës	6
1.3	Deklerata e „misionit“	6
1.4	Tarifat e shërbimit	7
2	SHËRBI TEKNIK	8
2.1	Qëllimet dhe objektivat kryesore	8
2.2	Aktivitetet kryesore nga Sh.Teknik	9
2.3	Rreziqet për mos arritjen e caqeve	10
2.4	Plani i minvestimeve kapitale	11
2.5	Perteritja e infrastruktures	12
2.6	Rritja e infrastruktures	13
2.7	Planifikimi i zvoglimit të UPF-se	13
2.8	Plani i menaxhimit të aseteve	14
2.9	Prodhimi – 2021-2023	15
3	SHËRBIMI PËR KONSUMATORË	16
3.1.1	Parashikimi i Kërkesës për ujë dhe rritja e konsumatorëve	11
3.1.2	Numri i Konsumatorëve- 2021-2023- KRU- HJ	12
3.1.3	Faturimi m3- 2021-2023- KRU- HJ	14
3.2	Gatishmëria për të paguar	16
3.2.1	Trendet e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve	16
3.2.2	Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve	17
3.2.3	Rregullimi/konvertimi i lidhjeve të paligjshme	17
3.2.4	Ndryshimet e mundshme në zonat operacionale	17
3	Plani Operacional	18
3.1.1	Planifikimi i zgjerimit të shërbimeve	18
3.1.2	Planifikimi i zgjerimit të shërbimeve- Sipas NJ.P	18
3.2.1	Plani i investimeve kapitale	22
3.2.2	Plani i investimeve – Ujësjellës dhe kanalizim (shtesa)	24

4	SHËRBIMI I FINANCAVE	27
4.1	Masat e planifikuara për arritjen e objektivave	27
4.2	Planifimi i i faturimit € - 2021-2023	28
4.3	Planifikimi i arkëtimit € - 2021-2023	30
4.4	Masat e planifikuara për arritjen e objektivave financiare	32
4.5	Analiza e shpenzimeve	32
4.5.1	Planifikimi i shpenzimeve	33
4.5.2	Arsyeshmeria e shpenzimeve	35
4.5.3	Planifikimi i kostos për ITUZ- Prizren	38
4.5.4	Parashikimi i rezeqeve financiare	40
4.6	Masat e planifikuara për arritjen e objektivave	40
4.7	Planifikimi i bonuseve dhe shperblimeve	42
4.8	Treguesit kryesor të performancës- 2021-2023	43
5	Plani i zhvillimit të stafit	44
6	Performanca operative dhe financiare	47
7	Investimet 2021-2023	48
8	Analizat e ujit – 2021-2023	52
	<i>SHTESA: 1</i>	
	<i>Plani investiv – 2021-2023</i>	
	ORGANOGRAMI	66

Skema Organizative – KRU Hidrodrini (Modeli 2)



*Vendet e detyrueshme sipas ligji

CAQET E APROVUARA NDËRMJET ARRU DHE KRU "HIDROREGJIONI-JUGOR" - VITI 2021

Këto caqe paraqesin obligim kontraktual ndërmjet KRU-së dhe ARRU për t'u përmbush gjatë vitit kalendrik biznesor 2021

Kategoria e të dhënave	Njësia	Aprovuar nga ARRU
		2021

PB - HRJ
2021

Tabela 1. Të dhënat operative

1.1 Uji i prodhuar	m ³ /vit	16,154,424
1.2 Uji i humbur	m ³ /vit	8,238,756
1.3 Uji i humbur në përqindje	%	51%
1.4 Uji i faturuar	m ³ /vit	7,915,668
2. Numri i konsumatorëve në fund të vitit		
2.1 Shtëpiak	Nr.	46,803
2.2 Komercial/Industrial	Nr.	5,991
2.3 Institucional	Nr.	328
Gjithsej:	Nr.	53,122
3. Numri i punëtorëve		
3.1 Shërbimet e ujësjellësit	Nr.	298
3.2 Shërbimet e ujërave të ndotura	Nr.	49
Gjithsej:	Nr.	347
4. Mbulueshmëria me shërbime		
4.1 Ujësjellës	%	79.86
4.2 Kanalizim	%	73.04
4.3 Trajtimit i ujërave të ndotura	%	0
5. Gjatësia e rrjetit		
5.1 Rrjeti i ujësjellësit	km	610
5.2 Rrjeti i kanalizimit	km	370

→ 18.445.185

→ 8.322.428

→ 53.080

Tabela 2. Shpenzimet operative

1. Shërbimet e ujësjellësit		
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit	2,053,086
1.2 Distribuim	€/vit	611,368
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit	558,297
Gjithsej:	€/vit	3,222,751
2. Shërbimet e ujërave të ndotura		
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit	450,116.00
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit	310,706
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit	259,342
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit	38,945
Gjithsej:	€/vit	1,059,109
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit	4,281,860

→ 4,536,300.60

Tabela 3. Faturimi

1. Shërbimet e ujësjellësit te konsumatorët		
1.1 Shtëpiak	€/vit	2,433,592
1.2 Komercial/Industrial	€/vit	490,683
1.3 Institucional	€/vit	521,980
Gjithsej:	€/vit	3,446,256
2. Shërbimet e ujërave të ndotura te konsumatorët		
2.1 Shtëpiak	€/vit	721,189
2.2 Komercial/Industrial	€/vit	211,118
2.3 Institucional	€/vit	397,007
Gjithsej:	€/vit	1,329,313
3. Tarifa fikse		
3.1 Shtëpiak	€/vit	561,708
3.2 Komercial/Industrial	€/vit	144,984
3.3 Institucional	€/vit	10,380
Gjithsej:	€/vit	717,072
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit	5,492,641

→ 5.494.312

56

CAQET E APROVUARA NDËRMJET ARRË DHE KRU "HIDROREGJIONI-JUGOR" - VITI 2021

Këto caqe paraqesin obligim kontraktual ndërmjet KRU-së dhe ARRË për t'u përmbush gjatë vitit kalendrik biznesor 2021

Kategoria e të dhënave	Njësia	Aprovuar nga ARRË
		2021

Tabela 4. Arkëtimi

1. Shërbimet e ujësjellësit te konsumatorët		
1.1 Shtëpiak	€/vit	2,755,676
1.2 Komercial/Industrial	€/vit	622,954
1.3 Institucional	€/vit	532,360
Gjithsej:	€/vit	3,910,991
2. Shërbimet e ujërave të ndotura te konsumatorët		
2.1 Shtëpiak	€/vit	663,494
2.2 Komercial/Industrial	€/vit	206,895
2.3 Institucional	€/vit	397,007
Gjithsej:	€/vit	1,267,396
3. Tarifa fikse		
3.1 Shtëpiak	€/vit	
3.2 Komercial/Industrial	€/vit	
3.3 Institucional	€/vit	
Gjithsej:	€/vit	
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit	5,178,386
3. Shkalla e arkëtitimit te konsumatorët		
3.1 Shtëpiak	%	92%
3.2 Komercial/Industrial	%	98%
3.3 Institucional	%	100%
Gjithsej:	%	94%

→ 5,134,197.74

Tabela 5. Investimet kapitale prej burimeve vetjake

1. Shërbimet e ujësjellësit		
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit	
1.2 Distribucim	€/vit	
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit	
Gjithsej:	€/vit	574,700
2. Shërbimet e ujërave të ndotura		
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit	
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit	
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit	
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit	
Gjithsej:	€/vit	186,000
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit	760,700

→ 602,700.000

Tabela 6. Investimet kapitale prej donacioneve

1. Shërbimet e ujësjellësit		
1.1 Resurse dhe trajtim	€/vit	13,535,000
1.2 Distribucim	€/vit	9,064,757
1.3 Aktivitete Biznesore	€/vit	16,000
Gjithsej:	€/vit	22,615,757
2. Shërbimet e ujërave të ndotura		
2.1 Grumbullimi i ujërave të ndotura	€/vit	3,075,000
2.2 Trajtimi i ujërave të ndotura	€/vit	15,150,000
2.3 Trajtimi i llumit	€/vit	-
2.4 Aktivitete Biznesore	€/vit	-
Gjithsej:	€/vit	18,225,000
Totali për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	€/vit	40,840,757

→ 46,584,614.74

Tabela 7. TARIFAT (€/m³)

		ME ITUN 2021	PA ITUN 2021
Shtëpiak uje	€/m ³	0.38	0.38
Shtëpiak kanalizim	€/m ³	0.14	0.08
Jo-shtëpiak Uje	€/m ³	0.67	0.67
Jo-shtëpiak Kanalizim	€/m ³	0.32	0.17



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Nr. prot./Prot. Nr./Prot. No	146
Njësia/Vendimi	0
Nr. shërb./Shërb./No	26/04/2021
Qend./Dau	PRISTINE

DATE/A	26 prill 2021
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefat Ekzekutiv të KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Raif Preteni, Drejtor ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përmbajtja e Biznes Planit Rregullator

Të nderuar Kryeshefa ekzekutiv,

Luteni që t'iu përmbaheni Biznes Planit Rregullator dhe të gjithë indikatorëve të performancës, veçanërisht t'iu përmbaheni planit të aprovuar të shpenzimeve operative, me theks të veçantë numrit të të punësuarve.

Përvoja e Autoritetit me numrin dhe profilin e të punësuarve ka qenë shqetësim edhe në të kaluarën.

Autoriteti kërkon nga ofruesit e shërbimeve që të jenë të kujdesshëm dhe të mos bëjnë punësime, kundrejt rekomandimeve të Autoritetit.

Jemi në vijim të Procesit Tarifor 2022-2024 dhe Autoriteti do ta vëzhgojë me vëmendje zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve nga ana e ofruesve të shërbimeve.

Mbesim me shpresë që në këtë tre vjeçar nuk do të kemi devijime të tilla.

Me respekt,

HYRJE

Plani i Biznesit për vitin 2021-2023 është një planifikim i caqeve kryesore të Kompanisë bazuar në një Modul i përgatitur paraprakisht. Planifikimi i caqeve bazohet në synimet e të gjitha Njësive punuese, në baza mujore dhe vjetore.

(Ekziston një modul i plotë në baza mujore)

Gjatë përgatitjes së këtij revidimi të Planit të Biznesit janë angazhuar të gjitha shërbimet përkatëse të Kompanisë.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar planifikimeve mujore të të gjitha performacave e veçanërisht atyre operative dhe financiare.

Forma e përgatitjes së këtij Plani të Biznesit është bazuar edhe në kërkesat për raportim nga ARRU si dhe institucionet tjera.

Qëllimi kryesorë i këtij moduli është thjeshtëzimi i mënyrës së kontrollit të performancave duke filluar nga shërbimet e caktuara, Njësitë Punuese e deri tek niveli regional.

Ky Plan definoi qartë orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe objektivat si dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake.

Plani është përgatitur duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendet e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë si dhe jashtë Kosovës për të adoptuar praktikatat më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë.

Plani i Biznesit 2021-2023 definoi qartë rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojë me një arritje të vetë qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat financiar dhe operativ janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme (duke lënë mundësinë e tejkalimit të të njëjtave) dhe të jenë sa më afër realitetit.

Plani i Biznesit është i orientuar fuqishëm edhe në drejtim të Institucioneve financiare dhe Donatorëve ku realizimi i këtij plani, e sidomos i Planit të investimeve kapitale është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga Donatorët, Institucionet financiare si dhe institucionet qendrore dhe lokale.

1. PERMBLEDHJA E PERGJITHSHME

1.1 Historiku i Kompanise

Në vitin 1962 ka filluar të ushtrojë veprimtarinë e saj si ndërmarrje Shoqërore e njohur me emrin “Cvileni”, që nga viti 1999 ka funksionuar si Ndërmarrje Publike nën DSHP shtylla e IV e UNMIK-ut, ndërsa që nga mesi i vitit 2003 kjo Kompani është regjionalizuar me 4 njësi në vete: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

Që nga Korriku i vitit 2007 funksionon si Shoqëri Aksionare K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A.

Kompania e ujësjellësit rajonal Hidroregjioni Jugor, shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës duke përfshirë këto komuna:

- **Komuna e Prizrenit** - Qyteti i Prizrenit dhe 35 Fshatra
(Numri total i fshatrave- 72)
- **Komuna e Suharekës** – Qyteti i Suharekës dhe 16 Fshatra
(Numri total i fshatrave – 42)
- **Komuna e Dragashit** – Qyteit i Dragashit dhe 3 Fshatra
(Numri total i fshatrave - 38)
- **Komuna e Malishevës** – Qyteti i Malishevës dhe 19 Fshatra
(Numri total i fshatrave - 44)
- **Komuna e Mamushës**

Rrjeti furnizues që i kryen shërbimet përfshinë 4 njësi operationale dhe 5 Komuna: Prizren, Suharekë, Dragash , Malishevë dhe Mamushë.

Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel te Kompanisë furnizohen edhe 64 fshatra që janë të kyçur ne rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë.

Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjellësit Regjional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

Kapaciteti prodhues përfshinë kapacitetet përmes puseve i cili është alternativ si dhe burimet të cilat nuk janë të shfrytëzuara aktualisht me kapacitet të plotë. Furnizimi bëhet 45% pompa, 55% me gravitet.

1.2 Deklarata e politikës

Menaxhmenti i KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtorëve, aksionarët, konsumatorët etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kanë për qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerë të të gjithë konsumatorëve në zonën e shërbimit.

Të vetëdijshëm se në kushtet e tanishme kjo është një gjë e pamundur do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe zhduken në tërësi humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimalizohen të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Prandaj është një prioritet i përcaktuar zvogëlimi i sasisë së ujit pa të ardhura dhe pagesa për shërbimet.

Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake.

Përmbushja e një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime nga donatorët dhe agjensionet tjera financiare.

1.3 Deklarata e "misionit"

Misioni i KUR "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do ta ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore.

Duke përmbushur këtë "mision" do të bëhet i mundur sigurimi i një aktiviteti të vetë financueshëm me qëllimin e fundit që të sigurojmë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

- Punëmarrësit,
- Aksionarët-Bordin e Drejtorëve - Qeveria
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministrinë MZHE dhe Ministria e Financave,
- ARRU (Autoriteti Rregullativ i Ujërave)
- Konsumatorët (të organizuar në komisione, shoqata etj).

1.4 Tarifat e shërbimit

Kompania KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. do të zbatojë tarifën e çmimeve që do ta vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina sipas Ligjit N 03/L-086 si autoritet i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave. Në bazë të kësaj Rregulloreje është përcaktuar “mbulimi i të gjitha kostove të operimit dhe investimeve”

Tarifat e miratuara nga ARRU do të jenë ekskluzivisht në funksion të mbulimit të shpenzimeve operative, rritjes së investimeve kapitale dhe përpjekjes për bashkëfinancimin e shumë projekteve të mundshme kapitale me komunitetin, me komunat përkatëse dhe me donatorët. Rritjet e reja do të ndikojnë pozitivisht dhe do të mobilizojnë menagjmentin dhe personelin tjetër në KUR “Hidroregjioni Jugor” SH.A. në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

TARIFAT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT TË ZEZA 2020

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike per ujë të pijes (Euro/m3)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom3)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.38	0.08
Konsumatori Komercial/Industrial	2.0	0.67	0.17
Konsumatori institucional	2.0	0.67	0.17

Koment: Ne raste të ndryshimit të vendimit nga ARRU, do të llogariten çaqet bazuar në ndryshimet eventuale

TARIFAT E PRITSHME PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT TË ZEZA 2021

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike per ujë të pijes (Euro/m3)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Euro/m3)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.38	0.13
Konsumatori Komercial/Industrial	2.0	0.67	0.29
Konsumatori institucional	2.0	0.67	0.29

2. SHËRBIMI TEKNIK

2.1 Qëllimet dhe objektivat kryesore

- Zgjerimin e zonës së shërbimit me ujësjellës deri në 96%;
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit;
- Vazhdimin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të konsumatorëve ekzistues dhe atyre të ri në 24 orë dhe rregullimin e shtypjes së ujit në zonat që kanë problem me shtypje të ulët;
- Vazhdimin e furnizimit me ujë të cilësisë që është në pajtim me standardet e IKSHPK, d.m.th. me 100% të pajtueshmërisë së testeve të ujit;
- Mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Adoptimin e plotë të Rregulloreve të ARRU përfshirë atë të Standardeve Minimale të Shërbimeve, Licencimit, Kartën e Konsumatorëve, Politikën Tarifore të ARRU, dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve si dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme që do të mund të mbulojnë shpenzimet operative dhe investimet e domosdomshme vjetore që do të dalin nga Planifikimi i arshshëm i Menaxhimit të Aseteve;

- Zhvillim i strategjive permes aktiviteteve te ndryshme per zvogelimin e humbjeve te ujit te pijes, ne theks te vecant vendosja e ujemtaesve te konsumatoreve ne prone publike gje qe pa mundeson keqperdorimin e ujit nga ana e konsumatoreve,
- Implementimi i te gjitha projekteve te planifikuara per vitet 2021-2023 e me theks te vecant ato te vitit 2021,
- Zonimi i sistemit te ujesjellesit per te siguruar furnizim conform standarteve te kerkuara,
- Formimi i DMA zonave, per mundesine e analizes se mirfillt teknike ne apsketin e zvogelimit te humbjeve teknike dhe administrative,
- Sanimi ne kohe dhe kualitet i te gjitha defekteve ne ujesjelles dhe kanalizim,
- Zgjerim te zones sherbyese me synim te rritjes se perqindjes se popullates ne casje te sherbimeve me uje te pijes dhe sherbime te mirembajtjes se kanalizimeve, me ndikim ambiental dhe ngritje socioekonomike per popullaten ne zonen tone te sherbimit,
- Zgjerimi i zones se sherbimit ne aspektin e mbulimit me trajtimin e ujerave te ndotura perms planifikimit dhe inicimit te projekteve per ndertimin e ITUZ-ve parciale dhe central.
- Promovimin e relacioneve te mira me konsumatorë;
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës për të gjithë të punësuarit dhe sigurimin fizik në punë;
- Sigurimin e stabilimenteve të një teknologjie moderne, të cilat përdoren për kryerjen e aktiviteteve të Kompanisë, të cilat i plotësojnë kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe të mjedisit;
- Regjistrimin dhe ruajtjen elektronike të të gjitha të dhënave dhe informacioneve të Kompanisë dhe organizimin e tyre në një Sistem Informativ Menaxhues funksional;
- Monitorimin e saktë të prodhimit dhe shpërndarjes së ujit, si dhe të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura përmes pajisjeve matëse të instaluar në pikat e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit duke përfshirë edhe sistemet elektronike monitoruese SCADA;
- Vazhdimin e avancimit të sistemit të të dhënave gjeografike (GIS) për të përfshirë tërë zonën e shërbimit, si dhe hartimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve;
- MMS-Sistemi i menaxhimit te mirembajtjes, i cili mundeson menaxhimin e urdheresave per mirembajtje.
- MMA-Aplikacioni mobil per menaxhimin e mirembajtjes.

- Rritja e transparencës në raportimet të cilat i bënë Kompania ndaj menaxhimit të kompanisë, Bordit dhe palëve të treta të interesuara;
- Përfundimi i ndërtimit të impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura;
- Mbajtjen edhe më tutje të vetëqëndrueshmërisë financiare, përmes rritjes së normës së mbulesës së punës;
- Rritja e vlerës së aseteve për periudhën.

2.2 Aktivitetet e planifikuara me qëllim të arritjes së caqeve

- -Aktivitetet e planifikuara janë në funksion të realizimit të projekteve të parapara në këtë Plan Biznes të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e caqeve:
- -Instalimi i ujëmtesve të prodhimit në të gjitha pikat prodhuese, të cilat do të na mundësojnë monitorim të sakt të prodhimit të ujit si dhe instalimi i sistemit SCADA e cila na mundëson monitorimin direkt të prodhimit të ujit të pijes.
- -Instalimi i ujëmtesve tek konsumatorët dhe atë në prone publike sa më afër gypit furnizues, me çrast teknikisht u pamundësohet konsumatorëve keqperdorimi eventual i ujit të pijes,
- -Zbatimi i rregulloreve të hartuara nga zyra e rregullatorit në lidhje me menaxhimin e sistemit të ujërave të zeza në aspektin e funksionimit,
- -Zbatimi i udhëzimeve administrative për shkakrimet e ujërave të zeza në sistem si dhe trajtimin e ujërave të zeza si kusht për shkarkim në recipient, pasi që në fillim të vitit 2021 do të fillojë operimi në ITUZ.
- -Mundësia e zhvillimit të stafit në aspektin profesional duke u mundësuar zhvillimin e trajnimeve në mënyrë që të jenë koherente me ndryshimet si atyre teknike po ashtu edhe atyre elektronike.

2.3 Rreziqet që mund të ndikojnë në mos arritjen e caqeve

- Rreziqet të cilat mund të ndikojnë në mos realizimin e caqeve mund të jenë:
- -Mos realizimi i investimeve të parapara në plan biznes,

- -Prolongimi i projekteve per shkak te deshtimit te investimeve nga agjencionet e huaja financiare, pasi qe disa nga projektet jane bashkfinancim,
- -Eficiencia operative ne aspektin e sanimit te defekteve e cila mund te rezultoj ne sigurine e cilesise se ujit, shtypjes dhe furnizimit te rregullt me uje te pijes, dhe ne plotesimin e standarteve minimale te sherbimit me uje te pijes dhe mirembajtje te kanalizimit.
- -Konsolidimi i softverit GIS dhe aplikacioneve MMS dhe MMA, te cilat drejtpersedrejti ndikojne ne mirembajtjen e aseteve te kompanise,
- -Per sa i perket dokumenteve te miratuara mbi rreziket e mundshme, kompania posedon:
 - 1.Planin e menaxhimit te thatesirave,
 - 2.Planin e furnizimit me uje te pijes ne situata emergjente,
 - 3. Planin e investimeve afatgjata,
 - -Tani jemi duke punuar ne hartimin e planeve te cilat kan te bejne me Menaxhimin e rrezikut dhe Menaxhimin e Krizave.

2.4 Plani i investimeve kapitale

Plani i Investimeve është një pjesë e rëndësishme e Planit të Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë shërbimet ndaj konsumatore. Përmirësimi i shërbimeve do të ndikojë edhe në përmirësimin e moralit të pagesave tek konsumatorët..

Plani i investimeve do të përbëhet prej një përzierje të projekteve, ku disa prej tyre do të jenë pjesë e financimit nga Kompania nga të ardhurat e tyre. Megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha të cilat kërkojnë financim të jashtëm edhe vlerësim të detajuar.

Qëllimi i Planit të Investimeve është që të sigurojë se Kompania është duke bërë planifikim të përshtatshëm për mirëmbajtjen e rregullt dhe zhvillimin e infrastrukture së ujësjellësit.

Identifikimi i investimeve, me qëllim të arritjes së ndryshimeve të standardeve të kualitetit apo shërbimeve shqyrtohet sipas vlerësimit të gjendjes së aseteve që janë në dispozicion me qëllim të arritjes së gadishmerisë teknike të pajimeve. Këto investime planifikohen të jenë pjesë e graveve nga KfW, MZHE, MEF, Kuvendi Komunal si dhe nga mjetet vetanake të Kompanisë.

Në bazë të analizës dhe gjendjes momentale që kemi në terren, ne kemi përcaktuar prioritetet e investimeve në nivel të Kompanisë-Njesive punuese.

Këto prioritetet janë të domosdoshme ngase:

- përmirësohet dukshëm furnizimi me ujë
- përmirësohet cilësia e ujit dhe shtypja konform standardeve në fuqi
- zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale
- shtohet numri i konsumatorëve të rinj
- zvogëlohen shpenzimet operative të mirëmbajtjes
- rritet shtimi i shërbimeve të Kompanisë
- evitohet mundësia e ndotjes së ujit të pijes nga ujërat e zeza

Planifikimi i investimeve për vitin 2021-2022-2023 është bazuar, në mundësinë e donacioneve si dhe programeve impementuese të Donatorëve si;

KfW- Projekt i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe Eficienca e energjisë elektrike, Faza V dhe VI- Rehabilitimi i rrjetit në sistemin ekzistues të kanalizimit

CDI- Programi për Rehabilitimin e zonave rurale

MZHE- Projektet e parapara sipas Programit PIP

Mjete Vetanake (nga Kompania)- Kemi përzgjedhur investimet prioritare në rehabilitim të rrjetit të ujësjellësit etj, duke u bazuar në mbëlueshmerinë operative.

Investimet në ujëra të zeza kryesisht janë prate të pastra Grand i Paste, përpos disa investimeve në rehabilitimin e rrjetit ekzistues në Suharekë dhe Prizren si dhe në aktivitete biznesore që parasheh kompania të bëjë me mjete vetanake

Sa i përket regjistrimit si asete, këto projekte janë në vijim dhe në momentin që do të finalizohen do të regjistrohen si asete,

Plani i investimeve- ujësjellës dhe kanalizim

(shiko shtesën: Investimet e planifikura 2021-2023

2.5 Përtëritjet e infrastrukturës

Me realizimin e këtyre investimeve do të kemi përmirësimin e kualitetit të ujit, shtimin e numrit të konsumatorëve, uljen e shpenzimeve të energjisë elektrike, zgjerimin e shërbimeve etj .

Në këtë planifikim është paraparë edhe investime në infrastrukturën e Re në rrjetin e Kanalizimit ,ku kemi ende pjesë të qyteteve dhe Fshatrave ku nuk kanë rrjet të kanalizimit

dhe derdhja e ujerave te zeza behet pa kurrfarë kriteri - kontrole dhe si rezultat i detyre ujerave kemi ndotje te ujerave sipërfaqësore , rrezikim te paraqitjeve te epidemive etj. Ne kuadër te investimeve është paraparë edhe trajtimi (përpunimi) i ujerave te cilët shkarkohen vend e pa vend ne pjese te Qyteteve dhe Fshatrave. Tani është momenti i fundit qe edhe ne te bëjmë planifikimin e trajtimit te ujerave te Zeza, është edhe kriter i Bashkësisë Evropiane qe ujërat e zeza para se te derdhen ne lum te behet trajtimi paraprak i ujit . Përpunimi i ujerave te zeza është i kushtueshmen. Ne te ardhmen do te kemi ngritje te çmimit për përpunimin e ujerave te zeza (Kuađer Profesionale , teknologji aplikative etj). Këto studime do te realizohem me ndihmën e KfW-se CDI, Kuvendit Komunal dhe Qeverise se Kosovës.

2.6 Rritja e infrastrukturës

Regjioni i Prizrenit ka një rrjet te ndërtuar ne periudha te ndryshme nga vitet e 60 si dhe nga materialet te ndryshme, Ne kemi bere planifikim e investimeve ne ndërrimin e rrjetit te ujësjellësit ne rrugët ku mendojmë se kemi humbje teknike, lidhje ilegale, si dhe presion te ulet.

Me realizimin e këtyre projekteve ne do te kemi përmirësimin e furnizimit me ujë, kualitetin e ujit te pijes, zvogëlimin e humbjeve teknike te ujit, uljen e shpenzimeve operative, shtimin e numrit te konsumatorëve .

Planifikimi investimeve Kapitale ne përtëritjen e infrastrukturës do të realizohet nga Buxheti i Kompanisë dhe Grandet , Buxheti Shtetit , Fondet e Njësive Vendore ku janë te paraqitura edhe ne Tabelën e Planifikimit te investimeve Kapitale .

Investimet ne përtëritje e infrastrukturës se Kanalizimit jene paraparë ne disa rruge ku kemi nevojë për investime se është rrjet i vjetër dhe tani nuk plotëson nevojat për rrugën ekzistuese, si dhe investime për parapërgatitje për ndarjen e ujerave te zeza dhe te shiut.

P.S: Plani i detajuar i investimeve 2021-2023 është I paraqitur në Shtesën e veçante

2.7 Planifikimi i zvogëlimit te humbjeve te ujit 2021-2023

Shërbimi Teknik në bashkëpunim me të gjitha shërbimet e tjera të kompanisë parashikon që deri në vitin 2023 të zvogëlojë humbjet e ujit nga 56% ne 52% . Kjo duke marre parasysh se zonat e reja qe priten te merren ne menaxhim ne fillim do te kenë humbje te mëdha te ujit. Këto synime mendojmë se janë reale dhe bazohen në këto faktorë;

- Zvogëlimi i humbjeve teknike
 - Zëvendësimi i rrjetit të vjetruar
 - Detektimi i rrjedhjeve të ujit

- Evidentimi dhe sanimi i rrjedhjeve nëntokësore dhe mbitokësore
- Etj.

➤ Zvogëlimi i humbjeve komerciale

- Evidentimi dhe eliminimi i lidhjeve të paligjshme
- Instalimi apo zëvendësimi i ujëmatësve
- Faturimi sipas konsumit real (eliminimi i faturimit paushall)

2.8 *Plani i menaxhimit te aseteve*

Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme të asetëve, mendojmë se nuk ka qenë një planifikim i mirëfilltë në menaxhimin e asetëve dhe gjendja e asetëve është në një gjendje jo të kënaqshme. Asetet që tani i kemi në shfrytëzim janë sipas periudhave të ndërtimit para lufte dhe pas lufte .

Duke parë gjendjen e asetëve pas lufte janë bërë investime në Rehabilitimin dhe ndërtimin e Rezervarëve të rinj rrjetet e ujësjellësve dhe kanalizimeve , fazineri, ujëmatës të profileve të ndryshme si dhe në mjetet e punës, ndihma me makineri në shtimin e sasisë së ujit ,në kualitetin e ujit.

Të gjitha këto ndihma ,investime kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së asetëve dhe performansës se Kompanive .

Tani kemi një gjendje më të mirë, por ka ende për të bërë .

Duke pasur parasysh gjendjen e asetëve dhe analizave të bëra nga të dhënat e përditshme kemi percaktuar objektivat dhe prioritetet e projekteve.

Objektivat tona për të pasur një menaxhim më të mirë dhe kontrollë mbi asetë janë;

- Zëvendësimi i rrjetave të vjetërsuara të ujit dhe kanalizimit
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit dhe kanalizimit,
- Zgjerimi i grupit i për detektimin e humbjeve,
- Zbatueshmeri e procedurave të punës, në përpikëri nga përgjegjësit e thirrur,
- Plotësimi i rregullatives së brendshme –adresimi më i mirë dhe më i saktë i përgjegjësive
- Planifikimi i resurseve njerëzore –trajnimet e nevojshme
- Shfrytëzimi i të gjitha veglave menaxhuese .
- Realizimi i projekteve sipas dinamikës së dhënë .

- Furnizimi me pajisje më të justifikueshme për detektimin e humbjeve dhe matjen sakte të prodhimit të ujit.
- Incizimin Gjeodezik, Digjitalizimi i rrjetit të kanalizimit dhe rrjetit të ujesjellsesit, Modelimi Hidraolik, perditesimi i te dhënave ne sistemin Auto Cad dhe sistemi i tyre ne GIS, Kriete keto te kërkua nga Donatoret si KfW, Qeveria e Kosoves etj po ashtu dhe nga ARRU-ja.

2.9 PRODHIMI – m3- 2021-2023

PLANI I BIZNESIT

PRODHIMI - 2020- 2023

2020-2023					
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN					
No.	Të dhënat	2020	2021	2022	2023
		m3	m3	m3	m3
	NJËSIA P.				
1	PRIZREN	12,311,888	12,612,598	12,662,091	13,011,547
2	SUHAREKË	2,403,199	2,350,727	2,546,457	2,616,735
3	MALISHEVË	1,469,072	2,057,951	2,665,161	2,738,715
4	DRAGASH	1,019,475	1,087,086	1,230,691	1,264,656
5	MAMUSHË		336,824	349,952	359,610
6	TOTAL	17,203,634	18,445,185	19,454,351	19,991,264
	NDRYSHIMI		1,241,551	1,009,166	536,913
	NDRYSHIMI %		7.2%	5.5%	2.8%

3. SHËRBIMI PËR KONSUMATORË

Departamenti Rajonal për Konsumatorë bënë organizimin e shërbimeve dhe marrëdhëniet me konsumatorët. Siguron performancë të mirë të shërbimeve për konsumatorët, siguron komunikimin me të gjitha departamentet tjera, ndërmer të gjitha hapat e nevojshme që të ngrisë shkallën e arkëtimit. Urdhëron ndërprejen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhërit. Organizon punën e ekipeve të inspektoratit dhe ç'kyçe, pranon raportet e tyre dhe ndërmer veprime të menjëhershme dhe urgjente. Pranon kërkesat për kyçe të reja, përgatitë dokumentacionin dhe i dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.

Departamenti me konsumatorë është departament i cili organizon dhe udhëheq punën me shërbimin me konsumatorë nëpër Njësit Operative , udhëheq dhe përcjell shërbimin e faturimit, inkasimin përmes arkave, lexuesve nw teren, inspektoratit dhe ç'kyçjes. Nëpërmes shërbimit të inspektoratit identifikon konsumatorët ilegalë bën legalizimin e tyre duke i zbatuar vendimet dhe rregulloret e brendshme të kompanisë. Gjithashtu udhëheq procedurat për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë, kordinon aktivitetet me Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Pranon ankesat, kërkesat e konsumatorëve, ato i shqyrton në pajtim me politikën, procedurat dhe rregulloret në fuqi, për të gjitha ankesat komerciale. Për punët dhe aktivitetet e veta ky departament i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Ky Departament ka zgjeru gamën e aktivitetëve të veta si në nivel të Njësit Operative ashtu edhe në nivel Rajonal ku nga dhjetori i vitit 2019 ka kaluar në nivel Departamenti dhe i raporton drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

Kompania është përfundimisht e orientuar në plotësimin dhe kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit të saj, si dhe sigurimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë. Departamenti me Konsumatorë edhe më tutje do të përmirësohet për të përfshirë regjistrimin dhe raportimin elektronikë, si dhe pranimin dhe shqyrtimin më efikas dhe brenda afateve kohore, të ankesave të konsumatorëve.

3.1.1 Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve

Të tabelat vijuese mund të shihni parashikimin e rritjes së numrit të konsumatorëve të ndara në tri kategori: amvisëri, biznese dhe institucione. Tabelat në vazhdim paraqesin rritjen e numrit të konsumatorëve dhe kërkesës për ujë në zonën aktuale të shërbimit si rezultat i lidhjeve të reja dhe konsumatorëve të paaautorizuar.

3.1.2 NUMRI I KONSUMATORËVE 2021 – 2023

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

2020-2023					
No.	Të dhënat	2020	2021	2022	2023
1	Shtëpiak	45,449	46,786	50,268	54,673
2	Ndryshimi		1,337	3,482	4,405
3	Ndryshi. %		2.9	7.4	8.8
4	Kome.-Indu.	5,964	5,961	6,003	6,067
5	Ndryshimi		(3)	42	64
6	Ndryshi. %		(0.1)	0.7	1.1
7	Institucional	323	333	347	355
8	Ndryshimi		10	14	8
9	Ndryshi. %		3.1	4.2	2.3
10	TOTAL	51,736	53,080	56,618	61,095
11	Ndryshimi		1,344	3,538	4,477
12	Ndryshi. %		2.6%	6.7%	7.9%

KOMENT

Paraqet numrin e konsumatorëve sipas muajve dhe njësive që do të ofrohen shërbimet e ujësjellësit e që do të shtohen data bazës së konsumatorëve për faturim. Në kuadër të rritjes së numrit të konsumatorëve, rreth 40% do të jenë konsumatorë mbrenda zonës së shërbimit ndërsa pjesa tjetër si zgjerim i zonës (shtrirja e menaxhimit edhe në fshatra në zona ruarale).

Departamenti Rajonal më Konsumatorë

1. Objektivat kryesore

KRU "Hidroregjioni Jugor" sha, objektivat kryesore ka furnizimin me ujë cilësor dhe të kontrolluar të gjithë konsumatorëve të zonës së shërbimit, të faturon për ujin e

shpenzuar, të kontrolloj konsumatorët për ujin e shpenzuar, të rris numrin e konsumatorëve rinjë në zonën në të cilën operon përmes pëlqimeve në kyçje në rrjet dhe legalizim.

2. Aktivitetet kryesore te planifikuara për arritjen e objektivave nga Departamenti Rajonal me Konsumatorë

- të lexoj rregullisht ujëmatësit për ujin e harxhuar
- të faturoj dhe shpërndaj faturat për konsumatorët rregullisht
- të legalizoj konsumatorët të cilët veq janë kyqur në shërbim sipas procedurave për legalizim
- rifreskimin e bazës së onsumatorëve me të dhëna të reja për konsumatorët si: ndryshim të emrit, ndryshim të pronës së konsumatorëve, kategorive etj
- të kërkoj nga konsumatorët inkasimin e faturave të shpërndara për konsumatorët
- të inicioj raste në përmbarrim për konsumatorët të cilët nuk kanë paguar shërbimet e ujësjellësit

3. Aktivitetet kryesore per zvoglimin e UPF-se

- të bëhen kontrolla dhe inspektime rutinore dhe të planifikuar nga ekipet e inspektoratit në nivel rajonal diku 1300-1500 konsumatorë për çdo muaj
- këto inspektime do të bëhen për zbulim të lidhjeve pas orës, manipulime me ujëmatës, kontrollimë të leximit të ujëmtësve etj
- të legalizohen të gjithë konsumatorët sipas procedurës së legalizimit
- të regjistrohen të gjithë konsumatorët të cilët kanë marrë pëlqim për kyqje në shërbime

4. Rreziqet qe mund te ndikojne ne mos arritjen e objektivave

- rritja e rasteve me Covid dhe shtërngimi i masave nga ana e Qeverisë
- rritja e numrit të rasteve sociale dhe pamundësisë së konsumatorëve për pagesat e shërbimeve të ujësjellësit
- pamundësia e leximit të rregullt të ujëmatwsve si rezultat i pamundësisë së qasjes në ujwmtws tek konsumatorwt (dyert e mbyllura).
- emigrimi i konsumatorëve dhe kthimi vetëm për pushime do të ul konsumin e faturuar dhe njëkohësisht uljen e të hyrave nga inkasimi
- rritja e numrit të konsumatorëve pasiv
- zbulimi i vonshëm i konsumatorëve të cilët janë kyq në rrjet

3.1.3 FATURIMI m3 - 2021 – 2023
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

2020-2023					
No.	Të dhënat	2020	2021	2022	2023
1	Shtëpiak	6,569,420	7,119,684	7,780,215	8,284,329
2	Ndryshimi		550,264	660,531	504,114
3	Ndry. %		8.4	9.3	6.5
4	Kome.-Indu.	465,875	682,926	687,487	708,997
5	Ndryshimi		217,051	4,561	21,510
6	Ndry. %		46.6	0.7	3.1
7	Institucional	510,405	519,820	536,764	547,608
8	Ndryshimi		9,415	16,944	10,844
9	Ndry. %		1.8	3.3	2.0
10	TOTAL	7,545,700	8,322,429	9,004,465	9,540,934
11	Ndryshimi		776,729	682,036	536,468
12	Ndry. %		10.3%	8.2%	6.0%

Faturimi mesatar per konsumatore ne vit - m3

2020-2023					
No.	Të dhënat	2020	2021	2022	2023
1	Amviseri	12.18	13.13	13.47	13.31
2	Biznes	6.55	9.56	9.58	9.77
3	Institucione	132.81	133.68	132.54	131.66
4	TOTAL	12.29	13.47	13.78	13.64

Faturimi per banore ne l/ditë

2020-2023					
No.	Të dhënat	2020	2021	2022	2023
1	Amviseri	81.21	87.53	89.83	88.71
2	Biznes	43.69	63.74	63.84	65.12
3	Institucione	81.90	89.82	91.86	90.93
4	TOTAL	81.90	89.82	91.86	90.93

KOMENT

Faturimi në m³ është rritur duke e rritur numrin e konsumatorëve si dhe mesataren e konsumit për secilin konsumatorë. Edhe pse është një sfidë e madhe rritja e konsumit mesatar për konsumatorë, Departamenti me Konsumatorë në bashkëpunim të ngushtë me departamentet tjera do të rris aktivitetet në këtë drejtim si: ndërrimin e matësve jofunksional, riparimet e rrjedhjeve të ujit në teren, rritja e presionit të ujit në zonat me preison të ulët, legalizimin dhe regjistrimin e menjëhershëm të të gjithë konsumatorëve.

Departamenti Rajonal më Konsumatorë

1. Objektivat kryesore

KRU "Hidroregjioni Jugor" sha, objektiv kryesore ka rritjen e sasisë së ujit të faturuar tek konsumatorët duke ndikuar në rritjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve në furnizim me ujë të bollshëm dhe cilësor.

2. Aktivitetet kryesore te planifikuara për arritjen e objektivave

- të furnizoj konsumatorët ekzistues me ujë të bollshëm dhe cilësor
- të furnizoj edhe konsumatorët e rinjë në zonat e reja të shërbimit
